



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3602/2026
Data: 20.04.2026

Nga mbledhja e tretë - III - për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27.03.2026, me fillim pune në ora 14:30 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Kryesuesin e Këshillit të Prindërve të shkollave.
3. Takim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik.
4. Eventuale.

Kryesuesi thekson: për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson: lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Kryesuesin e Këshillit të Prindërve të shkollave.

Kryesuesi thekson: përfaqësuesja e këshillit të prindërve nuk është prezente dhe nëse vjen ndërkohë, mundemi me diskutuar.

3. Takim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson: plani jonë për këtë vit është i bazuar te strategjia për zhvillim ekonomik, e cila është dokumenti më i rëndësishëm të cilin e kemi të hartuar, por që duhet me u harmonizuar me planin nacional që është prej Ministrisë dhe dikastereve të ndryshme. Kemi filluar me subvencionimin e bizneseve fillestare dhe ky vit është viti i tretë, e që normal që e kemi rritur edhe vlerën e buxhetimit. Në momentin që do të lëshohet buxheti nga Ministria e Financave, do të përgatitet thirrja për subvencionim të bizneseve, pastaj do të vazhdojmë me projektet kapitale, si tregu i qytetit, shtigjet e ecjes për hapësirat rekreative në Han të Elezit dhe nëpër fshatrat përreth, të cilat janë projekte që kanë filluar gjatë vitit të kaluar, por nuk kanë përfunduar për shkak të kushteve klimatike dhe buxhetit të limituar që e kemi pasur. Këta projekte janë propozuar gjatë debateve publike dhe nga kërkesat e bizneseve të cilat kanë qenë.

Kryesuesi thekson: te subvencionet për bizneset e reja, a keni ndonjë shifër se sa janë në këtë vit? A janë të gjitha aktive? A ka pasur ndonjë avancim të atyre bizneseve dhe a kanë ndikuar drejtpërdrejt në punësim?

Majlinda Kaloshi thekson: buxheti, kur është bërë në vitet e kaluara, ka qenë vlerë pak më e vogël, sepse ka qenë vetëm fillimi, sepse komunat e tjera e kanë pasur, ndërsa komuna jonë asnjëherë nuk e ka implementuar dhe vlera ka qenë 10 000 € për secilin biznes që i ka plotësuar kriteret. Në këtë vit të planifikuar i kemi 25 000 €, të cilat janë të ndara për subvencione dhe normalisht kërkesa ka shkuar vetëm duke u rritur. Kemi parë aktivitete të reja të gjinisë femërore, të cilat nuk po shkojnë vetëm me aktivitete të njëjta. Normalisht kanë nevojë për me u përmirësuar te forma e aplikimit, të cilën ne nuk mundemi me ndryshuar, por është direkt paketë e cila vjen prej Ministrisë.

Erblin Meliqi thekson: ku do të jetë lokacioni i tregut ditor dhe përzgjedhja e shitësve, ku kanë me pasur? A do të ketë ndonjë kriter që kanë me përmbushur? Fermerët që ju caktohet vendi se ku do t'i paraqesin produktet e tyre, a kanë me pasur ndonjë pagesë ndaj komunës që e ushtrojnë këtë veprimtari? Për sa kohë do t'i ipet fermerit që e ushtron atë veprimtari? Për sa kohë do t'u ipen në shfrytëzim?

Majlinda Kaloshi thekson: vendi është i përcaktuar, do të jetë hapësira mbrapa komunës dhe normalisht kishim filluar me implementim të projektit, por për shkak që duhet me u shpronësuar, nuk kemi mundur me filluar. Përparësi kanë me pasur bizneset lokale dhe ne personalisht nuk jemi dakord që ata me paguar, por duhet me i pasur disa kriteret të caktuara në mënyrë që mos me ndotur ambientin. Me rregullore për taksa dhe tarifa, kiosket i kemi të liruar prej taksave. Në fazat e aplikimit do të caktohen kushtet, kriteret dhe koha për sa kohë do t'u ipet.

Kryesuesi thekson: tregu a do të jetë me kioska të thjeshta apo më moderne?

Majlinda Kaloshi thekson: do të jenë kioske moderne.

Sead Vila thekson: kur do të përfundojë tregu si projekt i cili pritet me filluar. Tregtarët a janë biznese të regjistruara që edhe pa u hapur tregu janë taksapagues të bizneseve, apo më shumë janë ekonomi familjare që nuk janë të regjistruara si biznes. Te përfituesit e subvencioneve është mirë me pasur kujdes që me ua ndarë personave që me të vërtetë e meritojnë e jo vetëm me përcaktuar një person si mbulesë e pastaj me u destinuar mjetet për dikë që nuk e ka atë veprimtari biznesore, por ata të cilët i kanë veprimtaritë e përcaktuara të jenë më meritoret të cilët përfitojnë.

Majlinda Kaloshi thekson: përfituesve të subvencioneve nuk e di për cilën kohë je duke ju referuar, por në momentin që kemi ardhur si qeverisje është formuar komisioni dhe si drejtori nuk kemi të drejtë me qenë pjesë e komisioneve të vlerësimit, por komisioni ka nënshkruar deklaratat që nuk janë anonim nga dikush që e ka të familjes dhe besoj që vlerësimet janë meritore dhe neve na intereson që këto donacione me u shfrytëzuar në mënyrën sa më të mirë të mundshme dhe deri tash nuk kemi vërejtur ndonjë keqpërdorim të këtyre mjeteve, sepse janë raportet e monitorimit dhe i kanë të gjitha dëshmitë e pagesave që kryhen përmes transaksioneve bankare. Sa i përket përfitimit që e fiton dikush dhe përfiton dikush tjetër, nuk e di ndonjë rast specifik, por ka raste në Kosovë që biznesi është në emër të gruas e operon burri si shkak që me iu ikur taksave, kështu që ne nuk e kemi ndonjë formë legjitime që me mundur me e përcjellë këtë farë dukurie. Është edhe komisioni i ankesave për këtë çështje, por qe dy vite me radhë nuk kemi pasur ndonjë ankesë. Te koha e finalizimit të projektit është se, nëse Ministria e Financave na i jep dritën e gjelbër, kishim filluar me pjesën e shpronësimit dhe nuk mundemi me filluar me implementuar projektin pa e pasur pronën në emër të komunës dhe kohën e finalizimit nuk mundemi me e potencuar.

Ibadete Kuka thekson: projekti i pishave, sa finalizohet dhe a keni planifikuar që me bërë edhe një shpim të një pusi në mënyrë që me pasur edhe ujë atje.

Majlinda Kaloshi thekson: situacionet e para i kemi kryer me buxhet të vitit të kaluar, tash e kemi fazën finale. Shpimi i pusit për ujë është paraparë, por në fazën e dytë.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson: si drejtori e bujqësisë jemi munduar me i mbuluar të gjithë sektorët e bujqësisë dhe gjatë këtyre katër viteve drejtorja e bujqësisë, në bashkëpunim me shoqatat, ka investuar rreth 172 000 € dhe prej tyre 102 000 € janë nga buxheti i komunës, ndërsa 70 000 € janë nga shoqatat. Me këto mjete financiare janë përfshirë të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë. Ne do të vazhdojmë nga buxheti i komunës dhe me shoqata për me investuar për nevojat e fermerëve. Jemi në bashkëpunim me një shoqatë nga Turqia, pra "Tika", me të cilën do të shpërndahen 20 multikultivatorë. Kërkesë kemi parashtruar edhe nëpër shoqata të tjera.

Kryesuesi thekson: unë e di që drejtorja e bujqësisë ka një bashkëpunim të mirë me laboratorin Labi, sa është shifra që do të investohet dhe çka keni paraparë për me investuar. Komuna a jep subvencione për grurë. Përveç Labit, a kemi edhe ndonjë shoqatë tjetër që ka ndihmuar në komunën tonë në sektorë të ndryshëm.

Abduraman Bushi thekson: në këtë vit projektet të cilat i kam si drejtori e bujqësisë nuk janë të përshtatshme për ata, mirëpo ata kanë me pasur në mënyrë të përgjithshme dhe çdo fermer apo qytetar që don me u marrë me bujqësi ka të drejtë me aplikuar. Drejtorja e bujqësisë edhe për këtë vit prioritet kryesor e ka me i pajisur fermerët me pajisje bujqësore, trajnimet e fermerëve përmes shoqatave të ndryshme. Shifër të saktë nuk kam për Labin se sa i ka, por varet prej kërkesave që aplikojnë. Subvencionimi për grurë me ligj subvencionohet prej Qeverisë dhe komunat nuk kanë të drejtë me i subvencionuar. Jemi në bashkëpunim me Tikën turke për shpërndarjen e njëzet multikultivatorëve, që financohet komplet nga kjo shoqatë. Kërkesa kemi parashtruar edhe nëpër shoqata të tjera të ndryshme, por jemi në pritje të përgjigjeve.

Sead Vila thekson: a ka fermerë që nuk ka përfituar asnjëherë subvencione. Nëse krahasohemi si komunë me disa komuna tjera, te ne jepen shumë shpesh për produkte ose aktivitete të ndryshme. Jeni e vetmja drejtori që nuk keni asnjë zyrtar brenda drejtorisë. Si bëhet përzgjedhja e përfituesve, a janë ata persona adekuatë që e njohin lëminë e fushës.

Abduraman Bushi thekson: si drejtori nuk kemi zyrtarë, por vlerësimet bëhen nga zyrtarët komunalë, të cilët i shqyrtojnë aplikacionet se a janë me dokumentacion në rregull. Kërkesa ime ndaj komisionit është që me i përzgjedhur ata të cilët janë me dokumentacion në rregull dhe që janë më meritorë dhe me bërë përfshirje regjionale.

Valmira Bushi thekson: u diskutua shpërndarja e zërave, pajisjeve bujqësore, por a keni në plan me shpërndarë edhe kafshë.

Abduraman Bushi thekson: në vitin e parë kur e kam marrë drejtorinë e bujqësisë kam dalë në terren dhe kam biseduar me qytetarë dhe fermerë për nevojat të cilat i kanë për bujqësi. Kërkesë kam parashtruar për mëshqerra te një shoqatë skoceze, jemi në proces të verifikimit, por po presim përgjigje.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.


4.Eventuale

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 15:10.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Komitetit
Basri Derajani

